



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E DREJTËSISË

INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI
ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT
PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR
2022, NË KUADËR TË **STRATEGJISË
NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË
2021-2025**





Strategjia ndërsektorale e drejtësisë 2021 – 2025 është vazhdimi i rrugëtimit të përbashkët, të filluar në vitin 2014, për transformimin e sistemit të drejtësisë në një sistem drejtësie të pavarur, paanshëm dhe profesional, që në thelb ka si qëllim të mbrojtë interesat e çdo qytetari shqiptarë, me të njëjtën cilësi, sikurse mbrohen edhe interesat e çdo qytetari të Bashkimit Evropian. Ky dokument është shprehje e vullnetit të palëkundur të Qeverisë shqiptare që reformimi i sistemit të drejtësisë është rruga e duhur për jetësimin e ëndrrës së kahershme të qytetarëve shqiptarë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Ulsi Manja
Ministër i Drejtësisë

Informacion përmbledhës mbi Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe Planit të Veprimit 2021-2025

Shqipëria ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, më datë 24/12/2021.¹

Ky dokument strategjik ndahet në disa qëllime ku secili prej tyre kërkon të arrihen objektiva strategjike të posaçme, veprime për t'u ndërmarrë dhe një seri treguesish performance për të matur ecurinë drejt përmbushjes së qëllimeve. Konkretisht, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025 dhe Plani i saj i Veprimit përbëhet nga: 4 Qëllime Politike, 17 Objektiva Specifikë² dhe 186 masa.

Raporti monitorimit për periudhën kohore 1 janar - 30 qershor 2022, përfshin informacion të detajuar mbi qëndrueshmërinë e qëllimeve politike të planit të veprimit, problemet e hasura gjatë zbatimit, arritjet dhe sfidat institucionale. Ky raport është përgatitur nga Sektori i Monitorimit, Prioriteteve dhe Statistikave në Ministrinë e Drejtësisë (MD)³ me kontributin e institucioneve të pavarura, sektorëve të brendshëm të MD-së dhe institucioneve të varura, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e nismave specifike sipas kësaj Strategjie Ndërsektoriale. Disa nga gjetjet kryesore ndahen në këtë Informacion Përmbledhës, i cili ndjek të njëjtën strukturë organizative si plani i veprimit ndërsektorial të drejtësisë, i cili ndahet në qëllime politike, objektivat specifikë dhe masat e duhura për të arritur secilin qëllim.

Qëllimi Politik 1: Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien.

Procesi i rivlerësimit kalimtar mbetet një aspekt thelbësor i Reformës në Drejtësi dhe ritmi i zbatimit të tij vijon të monitorohet rreptësisht si pjesë e objektivave specifikë të kësaj Strategjie. Për periudhën e monitorimit janar-qershor 2022, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) ka marrë 23 vendime. Ka një rritje të lehtë të ritmit të procesit të vendimmarrjes në KPA, pasi gjatë gjithë vitit 2021 (janar-dhjetor 2021) janë marrë vendime për gjithsej 38 çështje. Megjithatë, treguesi i performancës së KPA, lidhur me numrin e çështjeve, i vendosur për këto 6 muaj nuk është arritur plotësisht. Për sa i përket llogaridhënies publike, KPA vazhdoi të mbajë një qasje të hapur ndaj publikut duke regjistruar dhe administruar 85 denoncime nga publiku për raste të veçanta. Ky numër i lartë denoncimesh gjatë periudhës janar-qershor 2022 tregon se besimi dhe pritshmëria e qytetarëve tek organet e rivlerësimit kalimtar vazhdon të jetë i lartë.

Në lidhje me përmirësimin e legjislacionit të reformës në drejtësi (Objektivi Specifik (O.S) 1.2.), gjatë periudhës raportuese janë marrë nisma ligjore të ndryshme. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka miratuar 2 akte nënligjore, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka miratuar 2 akte nënligjore dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka miratuar 5 akte normative. Ndërkohë, secili institucion po punon për nisma të reja ligjore.⁴

¹ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 823, datë 24.12.2021 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe Planit të saj të Veprimit".

² Shënim për në vijim të raportit: *Nuk është përfshirë Objektivi 3.3 në lidhje me Drejtësinë Penale për të Mitur. Kjo referencë është bërë në këtë dokument strategjik në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur. Plani i masave në zbatim të këtij objektiivi specifik nuk është përfshirë në planin e veprimit të SND 2021-2025 për të shmangur mbivendosjen me masat e parashikuara në Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur.


³ Urdhri i Kryeministrit nr.128, dt. 08.11.2021 "Për miratimin e strukturës dhe organizimit të Ministrisë së Drejtësisë"

⁴ Shih Masën 1.2.3 tek Plan Veprimi i SND (Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLGJ-në. Konsultimi dhe miratimi i akteve.)

Për sa i përket **ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë (O.S.1.3)** ka pasur përparime. Gjatë periudhës raportuese janar - qershor 2022, 24 magjistratë të rinj janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe KLP përfundoi verifikimin e pasurisë dhe figurës për 22 magjistratë prokurorë.⁵ KLGJ ka vijuar me plotësimin e vendeve të lira në sistem.⁶ ILD ka trajtuar 906 ankesa dhe gjatë periudhës raportuese janë regjistruar 435 ankesa të reja.⁷ Për trajtimin e çështjeve të prapambetura mbi masat disiplinore të paraqitura pranë ILD, ky institucion duhet të ngrëjë 2 mekanizma të cilat kanë për qëllim të administrojnë dhe t'i japin përparësi këtyre kërkesave.⁸ Gjatë periudhës raportuese është regjistruar 1 kërkesë për procedim disiplinor pranë ILD.

Si pjesë e rreziqeve dhe sfidave sipas këtij qëllimi politik, mund të përmendim ritmin e procesit të rivlerësimit kalimtar, i cili mund të ulet, për shkak të mungesës së burimeve financiare. Institucionet e reformës në drejtësi kanë vijuar të financohen nga buxheti i shtetit. Megjithatë, për periudhën raportuese buxheti i shtetit i dedikuar për institucionet e reformës në drejtësi ishte gjysma e objektivit të planifikuar. Dy masa që kërkojnë vëmendje të mëtejshme për të përmbushur objektivin e vendosur janë trajnimi i stafit të ILD-së nga aktorët ndërkombëtarë dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ASPA si dhe rikonstrukcioni i godinës aktuale të ILD-së sipas procedurave përkatëse.

Zbatueshmëria e objektivave specifike dhe masave të Planit të Veprimit për periudhën Janar - Qershor 2022 për qëllimin e parë të politikës



⁵ Vendime 103-124, datë 19.05.2022 të KLP

⁶ Gjatë periudhës raportuese janë emëruar 23 magjistratë të profilit të gjyqtarit. Një gjyqtar është transferuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe 6 gjyqtarë janë ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë, 9 gjyqtarë në juridiksionin e apelit dhe 3 në Gjykata Speciale.

⁷ Nga 906 ankesa të trajtuara pranë ILD: 694 ankesa të trajtuara me 476 vendime për arkivim pas shqyrtimit fillestar. 211 ankesa të trajtuara me 156 vendime për arkivim pas verifikimit;

⁸ Urdhri nr. 66, date 28.09.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin dhe kategorizimin e ankesave të të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare, deri në krijimin e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", dhe Urdhrit nr. 98, date 12.11.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për vazhdimin e trajtimit të ankesave apo praktikave të përcjella nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", duke i dhënë përparësi një kategorie të caktuar ankesash.

Qëllimi Politik 2: Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane.

Pjesë e rëndësishme e reformës në drejtësi është edhe rishikimi i procedurave para gjykatave, të cilat duhet të rishikohen për të pasur një sistem drejtësie më të aksesueshëm, transparent dhe efikas. Në këtë drejtim duhen marrë masa për rishikimin e dispozitave ligjore përkatëse në Kodin e Procedurës Civile,⁹ Ligjin "Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative"¹⁰, Kodin e Familjes apo ligjet për funksionimin e gjykatave. Për sa i përket ecurisë së këtij **O.S 2.1**, gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë disa nisma.

Më konkretisht, pas analizave të bëra dhe procesit të konsultimit, Kuvendi miratoi ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile dhe Ligjin për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative. Gjithashtu, KLGJ, ka miraturar 1 akt nënligjor mbi nëpunësit civil gjyqësorë, i cili rregullon pagesën e orëve shtesë.¹¹

Drejtësia kushtetuese vlerësohet si një shtyllë e rëndësishme e reformës në drejtësi, prandaj një nga objektivat specifike në këtë Qëllim të dytë Politik është forcimi dhe ngritja e kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi me burime të përshtatshme dhe funksionimi i saj i përgjithshëm, në një mënyrë transparente dhe efektive. Për periudhën janar - qershor 2022, janë vërejtur arritje në **O.S 2.2**. Një anëtar i ri i zgjedhur nga Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë u caktua në GJK dhe janë rekrutuar dy këshilltarë ligjorë në Shërbimin Juridik të Gjykatës. GJK në periudhën raportuese ka marrë 128 vendime. Rreziku për zbatimin e këtij objekti është i një niveli mesatar, pasi ka një probabilitet të lartë të ndodhjes dhe një ndikim mesatar. Problemet e evidentuara lidhen me kapacitetin institucional dhe financiar të GJK për të mundur infrastrukturën e nevojshme dhe logjistike për funksionimin e saj të mirë.

Objektivi i tretë specifik i këtij Qëllimi Politik është **rritja e efikasitetit dhe kapaciteteve profesionale të sistemit të trajnimit të magistratëve dhe këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë nga Shkolla e Magjistraturës**. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Shkolla e Magjistraturës (SHM) ka përgatitur programin dhe kalendarin për Trajnimin e Vazhdues, të cilat janë hartuar me kujdes, në përputhje me një metodologji efçente dhe bashkëkohore, duke ndërthurur mënyra të ndryshme për marrjen e informacionit për nevojat e sistemit. Trajnerët janë përzgjedhur në bazë të meritës dhe në transparencë të plotë, duke i dhënë përparësi rritjes së përfshirjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe duke ndjekur me kujdes procesin e përgatitjes së kurrikulave dhe modulet e trajnimit nga trajnerët. SHM ka rishikuar gjithashtu metodologjinë e vlerësimit për të ofruar më shumë garanci për paanshmërinë dhe profesionalizmin e këtij procesi. Për më tepër, rëndësi i është kushtuar kualifikimit të stafit ekspert trajnues (ose pedagogjik) për seminare të cilat janë krejtësisht të reja në aspektin e lëndës, ose që janë organizuar deri më tani nga SHM, por janë mbështetur pjesërisht nga ekspertë ndërkombëtarë.

Funksionimi i një sistemi gjyqësor efikas dhe efektiv në të gjitha nivelet (O.S 2.4), kërkon studime të vazhdueshme të pavarura dhe gjithëpërfshirëse të fizibilitetit, vlerësime të performancës së gjykatave, analiza të zbatimit të kodit të etikës, gjetje të raportimit publik si dhe bashkëpunim ndërinstucional dhe mekanizmin e bashkëpunimit me publikun e gjerë. Gjatë periudhës raportuese KLGJ ka hartuar Raportin Vjetor për analizën e sistemit gjyqësor, i cili raportohet një herë në vit. Gjithashtu, KLGJ ka kryer 2 analiza statistikore mbi të dhënat 3-mujore të performancës së gjykatave.¹²

Objektivi i fundit specifik nën këtë qëllim politik është **të sigurojë qasje efikase në drejtësi përmes ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave të përshtatshme gjyqësore (O.S 2.5)**. Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në MD (DNJF)

⁹ Ligji nr. 44/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare të datës 14.5.2021.

¹⁰ Ligji nr. 49/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare, datë 14.5.2021.


¹¹ Vendimi i KLGJ nr. 48 datë 08.02.2022

¹² Vendimi i KLGJ nr. 25 datë 07.02.2019

ka raportuar se 4311 persona kanë përfituar ndihmë juridike parësore të garantuar nga

shteti dhe 742 persona kanë përfituar ndihmë juridike dytësore të garantuar nga shteti.

Zbatueshmëria e objektivave specifike dhe masave të Planit të Veprimit për periudhën Janar - Qershor 2022 për qëllimin e Dytë të politikës



Qëllimi Politik 3: *Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazinë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.*

Për të arritur këtë Qëllim Politik, hapi i parë është të kemi një kuadër ligjor që ka një qasje të integruar dhe restauruese të drejtësisë, në vend të ndëshkimit. Për këtë arsye, një nga objektivat specifike të kësaj politike synimi është rishikimi dhe përditësimi i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale me qëllim **ndryshimin e dispozitave ligjore përkatëse drejt një sistemi penal juridik të risocializimit, riintegrimit dhe rehabilitimit (S.O 3.1)**. Lidhur me këtë, për periudhën raportuese janar-qershor 2022, me urdhër të MD, filloi puna për rishikimin e Kodit Penal aktual me qëllim hartimin e një Kodi të ri Penal. U krijua një grup pune me ekspertë të jashtëm me qëllim hartimin e një Kodi të ri Penal të karakterizuar nga stabiliteti, largpamësia, si dhe përshtatja me dinamizmin e marrëdhënieve ekzistuese shoqërore, në përputhje me aktet dhe jurisprudencën ndërkombëtare. Grupi i ekspertëve ka kryer një studim të detajuar dhe ka zhvilluar një metodologji të ndërhyrjes.

Nga ana tjetër, një drejtësi penale nuk do të ishte efektive në një sistem ku ka pandëshkueshmëri dhe nivel të lartë kriminaliteti. Kjo është arsyeja pse një nga objektivat specifike nën këtë qëllim politik kërkon një sistem proaktiv të ndjekjes penale i cili në **mënyrë efektive heton dhe ndjek penalisht korrupsionin dhe krimin e organizuar (O.S 3.2)**. Gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2022 janë marrë masa të ndryshme për rritjen e kapaciteteve hetimore të policisë dhe prokurorisë. Oficerët e policisë gjyqësore janë emëruar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe kanë kryer trajnime profesionale përpara fillimit të detyrës. Gjithashtu prokurorët janë trajnuar sipas temave specifike nga organizata të huaja si EURALIUS dhe OPDAT. Paketa e propozimeve për ndryshime në ligjin organik për prokurorinë është hartuar dhe ka kaluar në Komisionin e Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

OS 3.3: Përmirësimi i drejtësisë për të miturit duke garantuar drejtësi miqësore për të miturit që mbron interesat e tyre më të mira.¹³


Shërbimi i provës ka vazhduar përpjekjet drejt përmirësimit të standardeve të veta operacionale dhe metodologjive mbikëqyrëse dhe menaxhimit të rasteve, në mënyrë që të mbështesë risocializimin, riintegrimin dhe

¹³ Objektivi Specifik 3.3 në lidhje me Drejtësinë Penale për të Mitur nuk është përfshirë në planin e veprimit të SND 2021-2025 për të shmangur mbivendosjen me masat e parashikuara në draft Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur 22-26 e cila është në proces konsultimi.

rehabilitimin, dhe punon në përputhje me praktikat dhe standardet më të mira të BE-së (O.S 3.4). Norma e personave nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës me kusht ka plotësuar plotësisht objektivin e vendosur për periudhën raportuese janar-qershor 2022. Është miratuar një paketë e re ligjesh penitenciare, e cila synon të rregullojë menaxhimin e sistemit penitenciar në Shqipëri nën frymën e konventave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë¹⁴ për rritjen e kapaciteteve të shërbimit të provës dhe funksionimit të tij, u miratua programi për trajnimin fillestar dhe të vazhdues¹⁵ si dhe procedura të veçanta bashkëpunimi për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht.¹⁶

Gjithashtu, janë ndërmarrë projekte dhe trajnime në sistemin penitenciar, me qëllim përmirësimin e burimeve njerëzore dhe shfrytëzimin e planeve individuale të zhvillimit për të burgosurit (O.S 3.5). Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) ka ndërmarrë nismën e ristrukturimit dhe rialokimit të aseteve njerëzore profesionale dhe gjatë këtij procesi do të ngrihet një strukturë që do të mbulojë procesin e vlerësimit, analizës dhe prodhimit të gjetjeve analitike sa lidhet me efektshmërinë e institucionit. Plani i Integritetit i miratuar (2022-2024) vijon të monitorohet lidhur me masat e parashtruara në të për adresim risqesh. Bazuar në mbështetjen e KiE, DPB ka krijuar një grup pune ndërdisiplinor për ekstremizmin e dhunshëm.

Zbatueshmëria e objektivave specifike dhe masave të Planit të Veprimit për periudhën Janar - Qershor 2022 për qëllimin e Tretë të politikës



Qëllimi Politik 4: Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit.

Do të ishte e vështirë të arriheshin synimet e politikave të drejtësisë ndërsektoriale pa një koordinim kompetent dhe efektiv në të gjitha institucionet në sektorin e drejtësisë. Institucionet e drejtësisë nuk janë ishuj dhe nuk duhet të funksionojnë të pavarura nga njëri-tjetri. Një nga masat e krijuara për të kontribuar në këtë drejtim

është zhvillimi i një sistemi të integruar elektronik të drejtësisë (e-justice) me identifikues të unifikuar, sisteme të përditësuara të menaxhimit të çështjeve, regjistrim elektronik të bazuar në internet për të tre fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjet në regjistrat përkatës kombëtarë dhe bazat e të dhënave (O.S 4.1). Gjatë periudhës raportuese, KLGJ ka miratuar kërkesat për zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve,¹⁷ si dhe udhëzimet për zhvillimin e tij¹⁸ dhe është në fazën e prokurimit të ngritjes së infrastrukturës

¹⁴ Ligji nr. 78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës"

¹⁵ Urdhri nr. 80, datë 22.02.2022 i Ministrisë të Drejtësisë "Për miratimin e programit të trajnimit fillestar dhe vazhdues për Specialistët e Shërbimit të Provës".

¹⁶ Urdhri nr. 196, datë 06.05.2022 i Ministrisë të Drejtësisë "Për përcaktimin e procedurave të bashkëpunimit për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht".

¹⁷ Vendimi i KLGJ nr. 5 datë 09.06.2022 "Për miratimin e kërkesave për zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve"

¹⁸ Vendimi i KLGJ nr. 2, datë 25.02.2022, "Udhërrëfyesin për zhvillimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Çështjeve"


mbështetëse për sistemin e ri ICMIS.¹⁹ Megjithatë, për shkak të kuadrit ligjor aktual dhe pengesave teknologjike të mirëmbajtjes dhe integritimit të TIK, zbatimi i kësaj mase është sfidues.

Nuk është shënuar progres në këtë periudhë raportuese për O.S 4.2. **"Përmirësimi i sistemeve të koordinimit, menaxhimit të performancës dhe komunikimit përmes metodologjisë IPSIS.** MD do të ndërrmarë masat e nevojshëm me qëllim kryerjen e analizës së thelluar të përputhshmërisë të kuadrit strategjik / kapaciteteve institucionale të sektorit të drejtësisë me standardet IPSIS. Në periudhat vijuese do të vijojë implementimi i masave të cilat rezultojnë të pazbatuara apo në proces realizimi.

MD si një institucion udhëheqës për monitorimin e kësaj strategjie, **ka nevojë të zhvillojë kapacitetet dhe të rrisë burimet e veta si dhe**

të mbështesë institucionet e saj të pavarura (O.S 4.3). Ndonëse ka filluar një analizë për vlerësimin e nevojave, gjatë kësaj periudhe raportuese stafit të MD-së nuk i është ofruar asnjë trajnim në fushën e menaxhimit, aftësive, burimeve njerëzore apo inspektimeve. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar inspektime: përkatësisht, gjatë periudhës janar-qershor 2022 janë kryer 25 inspektime të përgjithshme; Janë iniciuar 5 hetime disiplinore në bazë të ankesave, 11 raporte janë përfunduar dhe 19 janë në proces shqyrtimi. Nga ana tjetër, ka patur progres në aspektin e kapaciteteve të MD-së në fushën e përafrimit të legjislacionit me acquis të BE-së. (S.O 4.4) Gjatë periudhës janar-qershor 2022 ASPA ka trajnuar në fushën e harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis-im e BE 23 pjesëmarrës janë nga MD; dhe janë trajnuar 35 nëpunës civilë në fushën e procedurave administrative dhe civile dhe harmonizimit të legjislacionit.

Zbatueshmëria e objektivave specifike dhe masave të Planit të Veprimit për periudhën Janar - Qershor 2022 për qëllimin e Katërt të politikës



¹⁹Vendimi i KLGJ nr. 7 datë 26.07.2022 i QTI

